

URDHËR
Nr. 292, datë 30.6.2026

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR NDËRKOMBËTARIZIMIN
DHE INTEGRIMIN EVROPIAN TË ZINXHIRIT TË VLERËS SË INDUSTRISË
TEKSTILE, VESHJEVE, LËKURËS DHE KËPUCËVE 2026–2027**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të VKM-së nr. 516, datë 25.9.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësi shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacioni”; të VKM-së nr. 621, datë 10.10.2024, “Për miratimin e dokumentit të politikës, ‘Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027’”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”, masa 1.1.6 “Promovimi i eksportit dhe ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve, konkretisht hapi 3: “Progres në iniciativat rregullatore dhe/ose masat mbështetëse në lidhje me partneritetet e zinxhirëve të vlerës industriale me Bashkimin Evropian”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Veprimit për Ndërkombëtarizimin dhe Integrimin Evropian të Zinxhirit të Vlerës së Industrisë Tekstile, Veshjeve, Lëkurës dhe Këpucëve 2026–2027, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave të Nxitjes së Biznesit për koordinimin e zbatimit të Planit të Veprimit për Ndërkombëtarizimin dhe Integrimin Evropian të Zinxhirit të Vlerës së Industrisë Tekstile, Veshjeve, Lëkurës dhe Këpucëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

PLAN VEPRIMI
PËR NDËRKOMBËTARIZIMIN, ZHVILLIMIN E PARTNERITETEVE DHE
INTEGRIMIN EVROPIAN TË ZINXHIRIT TË VLERËS SË SEKTORIT TË
TEKSTILEVE, VESHJEVE, LËKURËS DHE KËPUCËVE (TCLF) NË SHQIPËRI
2026–2027

PËRMBAJTJA

1. HYRJE
2. KONTEKSTI
3. VIZIONI
4. OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM
5. OBJEKTIVAT SPECIFIKË

6. SHTYLLAT STRATEGJIKE DHE VEPRIMET

SHTYLLA I: PROMOVIMI DHE NDËRKOMBËTARIZIMI

Veprimi 1.1: Pjesëmarrja në panaire dhe ekspozita ndërkombëtare tregtare

Veprimi 1.2: Promovimi i Shqipërisë si destinacion për *nearshoring* dhe prodhim

Veprimi 1.3: Forumi Vjetor i Partneritetit Shqipëri–BE për sektorin TCLF

SHTYLLA II: INFORMIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE SHKËMBIMI I NJOHURIVE

Veprimi 2.1: Programi i informimit mbi tregun e Bashkimit Evropian

Veprimi 2.2: Platforma e Informimit dhe Mbështetjes për sektorin TCLF

- Veprimi 2.3: Përgatitja e materialeve praktike informuese
- Veprimi 2.4: Përafrimi rregullator me kuadrin e Bashkimit Evropian për sektorin e tekstileve dhe këpucëve
- SHTYLLA III: ZHVILLIMI I PARTNERITETEVE DHE INTEGRIMI EVROPIAN
- Veprimi 3.1: Identifikimi dhe angazhimi i partnerëve evropianë
- Veprimi 3.2 Bashkëpunimi me shoqatat dhe rrjetet industriale evropiane
- Veprimi 3.3: Aktivitete për ndërmjetësimin e partneriteteve ndërmjet bizneseve (*Business-to-Business* – B2B)
- Veprimi 3.4: Partneritete për inovacionin dhe shkëmbimin e njohurive
- SHTYLLA IV: NGRITJA E KAPACITETEVE DHE ZHVILLIMI I AFTËSIVE
- Veprimi 4.1: Programi i trajnimit mbi mundësitë e tregut të Bashkimit Evropian
- Veprimi 4.2: Programi për gatishmërinë për eksport dhe zhvillimin e biznesit
- Veprimi 4.3: Vizita studimore dhe aktivitete për shkëmbimin e përvojës
7. IMPLEMENTATION ARRANGEMENTS
8. MONITORIMI DHE RAPORTIMI
9. REZULTATET E PRITSHME
9. TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS (KPI)
11. ANEKSET

PLANI I VEPRIMIT PËR NDËRKOMBËTARIZIMIN, ZHVILLIMIN E PARTNERITETEVE DHE INTEGRIMIN EVROPIAN TË ZINXHIRIT TË VLERËS SË SEKTORIT TË TEKSTILEVE, VESHJEVE, LËKURËS DHE KËPUCËVE (TCLF) NË SHQIPËRI 2026–2027

1. HYRJE

Ky Plan Veprimi është hartuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) si një nisim pilot, në kuadër të masës 1.1.6 të Agjendës së Reformave, e cila synon promovimin e eksporteve, ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve, lehtësimin e tregtisë dhe mbështetjen e zinxhirëve industrialë të vlerës me potencial rritjeje.

Sektori i tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF) është përzgjedhur si sektori prioritar pilot, për shkak të rëndësisë së tij strategjike për ekonominë shqiptare, orientimit të tij të fortë drejt eksporteve, integritit në rrjetet evropiane të prodhimit, si dhe potencialit të tij për zhvillim të mëtejshëm nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit me partnerët evropianë.

Ky Plan Veprimi mbështetet në punën analitike të kryer nga ministria përmes katër raporteve sektoriale, të cilat trajtojnë vlerësimin e zinxhirit të vlerës, analizën e kuadrit rregullator, masat mbështetëse, si dhe mundësitë për integrimin në zinxhirët industrialë evropianë të vlerës.

Puna analitike identifikoi një sërë sfidash kryesore që ndikojnë në konkurrueshmërinë dhe ndërkombëtarizimin e zinxhirit të vlerës së sektorit TCLF në Shqipëri. Raportet evidentuan dukshmërinë e kufizuar ndërkombëtare të prodhuesve shqiptarë, pjesëmarrjen e pamjaftueshme në rrjetet industriale dhe të biznesit evropian, aksesin e kufizuar në informacionin mbi tregjet, sfidat në rritje që lidhen me agjendën e Bashkimit Evropian për qëndrueshmërinë dhe ekonominë qarkulluese, si dhe mangësitë në aftësi dhe kompetenca që ndikojnë në konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve. Në të njëjtën kohë, analiza identifikoi mundësi të rëndësishme që burojnë nga rritja e kërkesës për *nearshoring*, zhvillimi i zinxhirëve evropianë të furnizimit më elastikë dhe baza e konsoliduar prodhuese e Shqipërisë. Këto gjetje përbëjnë bazën faktike mbi të cilën janë përcaktuar prioritetet dhe veprimet e përfshira në këtë Plan Veprimi.

Qëllimi i këtij Plani Veprimi është të krijojë një kuadër të koordinuar veprimesh, që synon forcimin e ndërkombëtarizimit, konkurrueshmërisë dhe integritit evropian të sektorit shqiptar

të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF), nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, zhvillimit të partneriteteve, promovimit të sektorit dhe ngritjes së kapaciteteve.

2. KONTEKSTI

Sektori i tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF) vijon të jetë një nga sektorët më të rëndësishëm të industrisë përpunuese dhe të orientuar drejt eksporteve në Shqipëri. Ky sektor mban marrëdhënie të qëndrueshme tregtare me tregjet evropiane, veçanërisht me Italinë dhe Gjermaninë, dhe luan një rol të rëndësishëm në krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin ekonomik rajonal.

Në të njëjtën kohë, ekosistemi evropian i tekstileve po kalon një proces të rëndësishëm transformimi, i udhëhequr nga objektivat për qëndrueshmërinë, parimet e ekonomisë qarkulluese, digjitalizimi dhe kërkesa në rritje për zinxhirë furnizimi më elastikë dhe gjeografikisht më pranë tregjeve evropiane.

Këto zhvillime krijojnë mundësi të reja për ndërmarrjet shqiptare që të forcojnë pozicionin e tyre në zinxhirët evropianë të vlerës, përmes intensifikimit të bashkëpunimit, rritjes së dukshmërisë, zhvillimit të partneriteteve më të forta dhe pjesëmarrjes më aktive në rrjetet industriale evropiane.

Për këtë arsye, ky Plan Veprimi synon të mbështesë ndërmarrjet në përshtatjen me kushtet në ndryshim të tregut, duke lehtësuar njëkohësisht integrimin më të ngushtë me partnerët dhe nismat evropiane.

Raportet analitike arrijnë, gjithashtu, në përfundimin se forcimi i konkurrueshmërisë së zinxhirit të vlerës së sektorit TCLF kërkon një qasje të koordinuar, e cila kombinon promovimin e eksporteve, përmirësimin e aksesit në informacion mbi tregjet, forcimin e partneriteteve ndërmjet bizneseve, përafrimin gradual të kuadrit rregullator me zhvillimet e kuadrit rregullator të Bashkimit Evropian, si dhe ngritjen e kapaciteteve të ndërmarrjeve. Veprimet e parashikuara në këtë Plan Veprimi i përgjigjen drejtpërdrejt këtyre rekomandimeve dhe synojnë të lehtësojnë integrimin gradual të ndërmarrjeve shqiptare në ekosistemet industriale dhe zinxhirët evropianë të vlerës.

Zbatimi i këtij Plani Veprimi plotëson Programin Kombëtar për Promovimin e Eksporteve, të miratuar nga qeveria, në dhjetor të vitit 2025. Ndërsa Programi Kombëtar për Promovimin e Eksporteve parashikon masa mbështetëse me karakter horizontal për eksportuesit shqiptarë, ky Plan Veprimi fokusohet në mënyrë të veçantë te zinxhiri i vlerës së sektorit TCLF dhe parashikon veprime të synuara për forcimin e partneriteteve ndërkombëtare, promovimin sektorial, integrimin evropian dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve, duke shmangur njëkohësisht mbivendosjen e aktiviteteve.

3. VIZIONI

Të forcohet konkurrueshmëria dhe prania ndërkombëtare e sektorit shqiptar të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF), si dhe të lehtësohet integrimi më i thellë i tij në ekosistemet industriale dhe zinxhirët evropianë të vlerës.

4. OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM

Të promovohet ndërkombëtarizimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i zinxhirit të vlerës së sektorit shqiptar të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF), nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit, shkëmbimit të njohurive, zhvillimit të partneriteteve të biznesit dhe intensifikimit të angazhimit me tregjet dhe institucionet evropiane.

5. OBJEKTIVAT SPECIFIKË

OS1

Të rritet vizibiliteti dhe promovimi i sektorit të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF) në tregjet evropiane.

OS2

Të përmirësohet aksesimi në informacion dhe njohuri mbi zhvillimet, dhe mundësitë në tregjet evropiane.

OS3

Të forcohet bashkëpunimi ndërmjet ndërmarrjeve shqiptare dhe kompanive, organizatave dhe institucioneve evropiane.

OS4

Të mbështetet krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit ndërmjet bizneseve, inovacioni dhe transferimi i njohurive.

OS5

Të forcohen aftësitë dhe kapacitetet e ndërmarrjeve dhe punëmarrësve që veprojnë në zinxhirin e vlerës së sektorit TCLF.

6. SHTYLLAT STRATEGJIKE DHE VEPRIMET

Veprimet e përfshira në secilën shtyllë strategjike janë hartuar mbi bazën e gjetjeve dhe rekomandimeve të raporteve analitike të përgatitura nga ministria. Çdo veprim adreson sfidat dhe mundësitë e identifikuara përgjatë zinxhirit të vlerës së sektorit TCLF dhe kontribuon në forcimin e konkurrueshmërisë, ndërkombëtarizimit dhe integritit të tij në ekosistemet industriale evropiane.

SHTYLLA I: PROMOVIMI DHE NDËRKOMBËTARIZIMI

Objektivi

Të rritet dukshmëria e ndërmarrjeve shqiptare të sektorit të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF) dhe të lehtësohet akses i tyre në tregjet evropiane dhe mundësitë e biznesit.

Veprimi 1.1: Pjesëmarrja në panairë dhe ekspozita ndërkombëtare tregtare

Aktivitetet:

- Lehtësimi i pjesëmarrjes së ndërmarrjeve shqiptare në panairët kryesore evropiane të tekstilit dhe modës;
- Organizimi i pjesëmarrjes me përfaqësim kombëtar në aktivitete të përzgjedhura ndërkombëtare;
- Promovimi i kapaciteteve prodhuese dhe potencialit eksportues të Shqipërisë.

Institucionet përgjegjëse: MEI, AIDA

Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 1.2: Promovimi i Shqipërisë si destinacion për *nearshoring* dhe prodhim

Aktivitetet:

- Përgatitja e materialeve promovuese që prezantojnë sektorin shqiptar të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF);
- Hartimi i një direktorie digjitale të prodhuesve shqiptarë;
- Promovimi i kapaciteteve prodhuese të Shqipërisë në tregje të përzgjedhura të Bashkimit Evropian.

Institucionet përgjegjëse: MEI, AIDA

Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 1.3: Forumi Vjetor i Partneritetit Shqipëri–BE për sektorin TCLF

Aktivitetet:

- Organizimi i Forumit Vjetor të Partneritetit Shqipëri–BE për sektorin TCLF, me pjesëmarrjen e institucioneve publike, shoqatave të biznesit dhe aktorëve evropianë;
- Prezantimi i mundësive për investime, eksporte dhe bashkëpunim në sektorin shqiptar të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF);
- Promovimi i dialogut për politikat dhe i bashkëpunimit institucional në mbështetje të integritit të zinxhirit të vlerës së sektorit shqiptar TCLF në ekosistemet industriale evropiane.

Institucioni përgjegjës: MEI

Afati kohor: Çdo vit

SHTYLLA II: INFORMIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE SHKËMBIMI I NJOHURIVE

Objektivi

Të rritet niveli i ndërgjegjësimit të ndërmarrjeve mbi zhvillimet e tregut, tendencat në fushën e qëndrueshmërisë dhe mundësitë që ofron ekosistemi evropian i tekstileve.

Veprimi 2.1: Programi i Informimit mbi Tregun e Bashkimit Evropian

Aktivitetet:

- Organizimi i sesioneve informuese dhe punëtorive;
- Shpërndarja e informacionit mbi tendencat në fushën e qëndrueshmërisë dhe zhvillimet që lidhen me ekonominë qarkulluese;
- Informimi mbi kërkesat dhe mundësitë në zhvillim të tregut evropian.

Institucioni përgjegjës: MEI

Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 2.2: Platforma e Informimit dhe Mbështetjes për sektorin TCLF

Aktivitetet:

- Zhvillimi i një platforme elektronike informimi për sektorin;
- Sigurimi i aksesit në informacion praktik, mundësi dhe burime të dobishme;
- Publikimi i përditësimeve mbi zhvillimet me rëndësi për sektorin;
- Promovimi i përdorimit të Platformës së Ekosistemit Evropian të Tekstileve dhe lehtësimi i aksesit të ndërmarrjeve shqiptare në informacionin dhe shërbimet përkatëse evropiane;
- Vendosja e lidhjeve ndërmjet platformës kombëtare të informimit dhe platformave evropiane përkatëse të informimit, si dhe rrjeteve të mbështetjes së biznesit.

Institucioni përgjegjës: MEI

Afati kohor: 2026

Veprimi 2.3: Përgatitja e materialeve praktike informuese

Aktivitetet:

- Përgatitja e udhëzuesve mbi mundësitë për eksport;
- Publikimi i materialeve informuese mbi programet dhe nismat evropiane;
- Zhvillimi i burimeve praktike për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) që operojnë në sektorin TCLF.

Institucioni përgjegjës: MEI

Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 2.4: Përafrimi rregullator me kuadrin e Bashkimit Evropian për sektorin e tekstileve dhe këpucëve

Aktivitetet:

- Monitorimi i zhvillimeve në legjislacionin e Bashkimit Evropian që lidhen me ekosistemin e tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve;
- Përgatitja e vlerësimeve mbi zhvillimet rregullatore dhe identifikimi i fushave që kërkojnë përafrim gradual;
- Organizimi i konsultimeve me institucionet publike, shoqatat e biznesit dhe ndërmarrjet mbi kërkesat e ardhshme rregullatore të Bashkimit Evropian;
- Mbështetja e përgatitjes, miratimit dhe zbatimit të masave prioritare rregullatore dhe të politikave të identifikuara në Raportin e Analizës Rregullatore, në përputhje me procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe me përafrimin progresiv me **acquis**-in e Bashkimit Evropian në fushën e tekstileve dhe këpucëve.

Institucioni përgjegjës: MEI

Afati kohor: 2026–2027

SHTYLLA III: ZHVILLIMI I PARTNERITETEVE DHE INTEGRIMI EVROPIAN

Objektivi

Të forcohet bashkëpunimi dhe lidhjet e biznesit ndërmjet aktorëve shqiptarë dhe evropianë.

Veprimi 3.1: Identifikimi dhe angazhimi i partnerëve evropianë

Aktivitetet:

- Identifikimi i partnerëve dhe rrjeteve përkatëse evropiane;

- Lehtësimi i kontakteve ndërmjet ndërmarrjeve shqiptare dhe evropiane;
- Mbështetja e misionëve të biznesit dhe nismave për zhvillimin e partneriteteve.

Institucionet përgjegjëse: MEI, AIDA

Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 3.2: Bashkëpunimi me shoqatat dhe rrjetet industriale evropiane

Aktivitetet:

- Promovimi i pjesëmarrjes në rrjetet dhe platformat evropiane të sektorit të tekstileve;
- Vendosja e bashkëpunimit me organizatat përkatëse industriale evropiane;
- Nxitja e pjesëmarrjes në iniciativa të klasterëve dhe partneriteteve.

Institucioni përgjegjës: MEI

Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 3.3: Aktivitete për ndërmjetësimin e partneriteteve ndërmjet bizneseve (Business-to-Business – B2B)

Aktivitetet:

- Organizimi i aktiviteteve sektoriale për ndërmjetësimin e partneriteteve ndërmjet bizneseve shqiptare dhe evropiane (B2B);
- Lehtësimi i vizitave në ndërmarrje dhe takimeve dypalëshe të biznesit;
- Mbështetja e kontakteve të mëtejshme ndërmjet bizneseve dhe krijimit të partneriteteve afatgjata tregtare;
- Promovimi i pjesëmarrjes në iniciativa për ndërmjetësimin e partneriteteve, si në format fizik ashtu edhe virtual.

Institucionet përgjegjëse: MEI, AIDA

Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 3.4: Partneritete për inovacionin dhe shkëmbimin e njohurive

Aktivitetet:

- Lehtësimi i bashkëpunimit me institucionet evropiane të kërkimit shkencor dhe inovacionit;
- Nxitja e pjesëmarrjes në projekte bashkëpunimi;
- Promovimi i shkëmbimit të praktikave më të mira dhe ekspertizës.

Institucioni përgjegjës: MEI

Afati kohor: 2026–2027

SHTYLLA IV: NGRITJA E KAPACITETEVE DHE ZHVILLIMI I AFTËSIVE

Objekti

Të forcohen kapacitetet dhe aftësitë e ndërmarrjeve dhe punëmarrësve që operojnë në zinxhirin e vlerës së sektorit të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF).

Veprimi 4.1: Programi i Trajnimit mbi Mundësitë e Tregut të Bashkimit Evropian

Aktivitetet:

- Organizimi i sesioneve të trajnimit për ndërmarrjet;
- Përmirësimi i njohurive mbi mundësitë e tregut dhe qasjet për zhvillimin e biznesit;
- Promovimi i njohurive mbi praktikën e konkurrueshmërisë dhe inovacionit.

Institucioni përgjegjës: MEI

Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 4.2: Programi për Gatishmërinë për Eksport dhe Zhvillimin e Biznesit

Aktivitetet:

- Ofrimi i trajnimeve mbi promovimin e eksporteve dhe ndërkombëtarizimin;
- Mbështetja e zhvillimit të kapaciteteve në fushën e markës (*branding*) dhe marketingut;
- Promovimi i përdorimit të mjeteve digjitale për biznesin dhe i mundësive për akses në treg.

Institucionet përgjegjëse: MEI, AIDA

Afati kohor: 2026–2027

Veprimi 4.3: Vizita studimore dhe aktivitete për shkëmbimin e përvojës

Aktivitetet:

- Organizimi i vizitave studimore në vende të përzgjedhura evropiane;
- Lehtësimi i shkëmbimit të përvojës me ndërmarrje dhe organizata evropiane;
- Promovimi i të nxënit nga përvojat e suksesshme evropiane.

Institucioni përgjegjës: MEI

Afati kohor: 2026–2027

7. IMPLEMENTATION ARRANGEMENTS

The Ministry of Economy and Innovation (MEI) shall serve as the lead institution responsible for coordinating the implementation of this Action Plan.

Implementation will be carried out in cooperation with relevant public institutions, business associations, chambers of commerce, educational institutions, development partners and private sector stakeholders.

MEI will ensure coordination among stakeholders and facilitate communication with relevant European partners and institutions.

Implementation of this Action Plan will be closely coordinated with the National Export Promotion Programme, the National Industrial Strategy, the SME Policy Document and other relevant policy initiatives to ensure complementarity, maximise synergies and avoid duplication of activities.

8. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) do të monitorojë zbatimin e këtij Plani Veprimi përmes rishikimeve periodike dhe vlerësimeve të progresit.

Monitorimi do të fokusohet në arritjen e produkteve konkrete dhe rezultateve të matshme, duke përfshirë:

- Numrin e aktiviteteve promovuese të organizuara;
- Numrin e ndërmarrjeve pjesëmarrëse në panaire dhe ekspozita ndërkombëtare;
- Numrin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere të zhvilluara;
- Numrin e ndërmarrjeve përfituese nga aktivitetet e trajnimit;
- Numrin e takimeve ndërmjet bizneseve (B2B) të lehtësuara;
- Numrin e nismave të bashkëpunimit të krijuara me partnerë evropianë;
- Numrin e vizitave studimore dhe aktiviteteve të shkëmbimit të përvojës të organizuara.

Rishikime vjetore të progresit mund të ndërmerren për të vlerësuar ecurinë e zbatimit dhe për të identifikuar mundësi për forcimin e mëtejshëm të integritit të sektorit shqiptar të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF) në zinxhirët evropianë të vlerës.

Progresi do të shqyrtohet çdo gjashtë muaj nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit. Raportet vjetore të zbatimit do të vlerësojnë progresin në raport me veprimet e planifikuara dhe treguesit kryesorë të performancës (KPI), do të identifikojnë sfidat e hasura gjatë zbatimit dhe, kur të jetë e nevojshme, do të rekomandojnë masa korrigjuese për përmirësimin e zbatimit të Planit.

9. REZULTATET E PRITSHME

Deri në fund të vitit 2027, zbatimi i këtij Plani Veprimi pritet të kontribuojë në:

- Rritjen e dukshmërisë së sektorit shqiptar të tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF) në tregjet evropiane;
- Rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit mbi zhvillimet dhe mundësitë në tregjet evropiane;
- Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve shqiptarë dhe evropianë;
- Rritjen e pjesëmarrjes së ndërmarrjeve shqiptare në aktivitete ndërkombëtare të biznesit;
- Përmirësimin e aksesit në informacion dhe mundësi për krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit;
- Forcimin e kapaciteteve të ndërmarrjeve dhe punëmarrësve që operojnë në zinxhirin e vlerës së sektorit TCLF;

- Integrimin më të thellë të ndërmarrjeve shqiptare në ekosistemet industriale dhe zinxhirët evropianë të vlerës.

9. TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS (KPI)

Veprimi	Treguesi kryesor i performancës (KPI)	Vlera bazë (2025)	Objektivi (2027)*	Buxheti indikativ (lekë)	Burimi i mundshëm i financimit
Veprimi 1.1: Pjesëmarrja në panaire dhe ekspozita ndërkombëtare tregtare	Pjesëmarrja në panaire dhe ekspozita ndërkombëtare të mbështetura nga MEI/AIDA	2 aktivitete kryesore	8	2,450,000	Buxheti i shtetit (MEI), AIDA
Veprimi 1.2: Promovimi i Shqipërisë si destinacion për <i>nearshoring</i> dhe prodhim	Fushata ndërkombëtare promovuese dhe informuese të organizuara	2	6	1,470,000	Buxheti i shtetit (MEI), AIDA
Veprimi 1.3: Forumi Vjetor i Partneritetit Shqipëri-BE për sektorin TCLF	Misione biznesi, aktivitete B2B dhe forume partneriteti të organizuara	4	10	1,960,000	Buxheti i shtetit (MEI), Partnerë Zhvillimi
Veprimi 2.1: Programi i Informimit mbi Tregun e Bashkimit Evropian	Aktivitete ndërgjegjëse, punëtori dhe sesione informuese të organizuara	12	25	980,000	Buxheti i shtetit (MEI)
Veprimi 2.1: Programi i Informimit mbi Tregun e Bashkimit Evropian	Ndërmarrje pjesëmarrëse në aktivitetet informuese dhe ndërgjegjëse	60	250	—	—
Veprimi 2.2: Platforma e Informimit dhe Mbështetjes për sektorin TCLF	Platforma elektronike e informimit për sektorin TCLF funksionale	Jo	Po	2,940,000	IPA/projekte të financuara nga donatorët
Veprimi 2.2: Platforma e Informimit dhe Mbështetjes për sektorin TCLF	Ndërmarrje të sektorit TCLF të përfshira në iniciativa promovimi dhe informimi	n/a	150	—	—
Veprimi 2.3: Përgatitja e materialeve praktike informuese	Materiale praktike informuese dhe udhëzues të përgatitur dhe të shpërndarë**	0	10	490,000	Buxheti i shtetit (MEI)
Veprimi 2.4: Përafrimi rregullator me kuadrin e BE-së për sektorin e tekstileve dhe këpucëve	Vlerësime rregullatore, konsultime me palët e interesit dhe masa zbatimi të përfunduara	0	4	980,000	Buxheti i shtetit (MEI), asistencë teknike IPA
Veprimi 3.1: Identifikimi dhe angazhimi i partnerëve evropianë	Marrëveshje bashkëpunimi dhe partneritete me organizata evropiane dhe ndërkombëtare	10	15	1,470,000	Buxheti i shtetit (MEI), programet e BE-së
Veprimi 3.2: Bashkëpunimi me shoqatat dhe rrjetet industriale evropiane	Partneritete të krijuara ndërmjet ndërmarrjeve shqiptare të sektorit TCLF dhe partnerëve të BE-së	n/a	20	784,000	Projekte të financuara nga BE-ja
Veprimi 3.3:	Takime B2B të	15	100	1,960,000	Buxheti i shtetit

Aktivite për ndërmjetësimin e partneriteteve ndërmjet bizneseve (B2B)	lehtësuara				(MEI), AIDA
Veprimi 3.3: Aktivite për ndërmjetësimin e partneriteteve ndërmjet bizneseve (B2B)	Kompani pjesëmarrëse në aktivitetet e ndërmjetësimit dhe zhvillimit të partneriteteve	18	100	—	—
Veprimi 3.3: Aktivite për ndërmjetësimin e partneriteteve ndërmjet bizneseve (B2B)	Kompani të përfshira në aktivite partneriteti dhe rrjetëzimi	112	200	—	—
Veprimi 3.4: Partneritete për inovacionin dhe shkëmbimin e njohurive	Vizita studimore dhe aktivite të shkëmbimit të njohurive të organizuara	0	6	1,470,000	Partnerë zhvillimi
Veprimet 4.1–4.3: Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i aftësive	Programe trajnimi të zhvilluara	12	20	2,940,000	Buxheti i shtetit (MEI), partnerë zhvillimi
Veprimet 4.1–4.3: Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i aftësive	Ndërmarrje përfituese nga aktivitetet e trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve	60	250	—	—

* Objektivat për vitin 2027 janë kumulative dhe përfaqësojnë rezultatet totale që pritet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit 2026–2027.

** Tregues i ri i propozuar për të lehtësuar monitorimin e zbatimit të veprimit 2.3.

Buxhetet orientuese të paraqitura më sipër përfaqësojnë vlerësime paraprake të planifikimit, të përgatitura vetëm për të mbështetur procesin e planifikimit të zbatimit të këtij Plani Veprimi. Alokimet faktike vjetore do të përcaktohen në kuadër të procesit vjetor të planifikimit buxhetor të qeverisë dhe do të varen nga disponueshmëria e fondeve të buxhetit të shtetit dhe e financimeve nga burime të jashtme.

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) do të koordinojë monitorimin e Treguesve Kryesorë të Performancës (KPI), në bashkëpunim me AIDA-n, shoqatat e biznesit dhe partnerët e tjerë zbatues.

11. ANEKSET

Aneksi I – Raporti i Vlerësimit të Zinxhirit të Vlerës së Sektorit të Tekstileve

Aneksi II – Raporti mbi Zhvillimin e Nismave Rregullatore dhe Rekomandimeve të Politikave

Aneksi III – Raporti mbi Zhvillimin e Masave dhe Nismave Mbështetëse

Aneksi IV – Raporti mbi Forcimin e Partneriteteve të Industrisë së Tekstileve me Bashkimin Evropian Union Report